



Internship Programme of German Business 2025

FOR THE COUNTRIES OF THE WESTERN BALKANS

A po afrohet fundi i studimeve tuaja? Çfarë do të vijë më pas? A keni plane për fillimin e karrierës suaj dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional apo jeni ende të pasigurt për cilën rrugë të zgjidhni? A ju mungon **hapi i fundit midis të qenit student dhe të qenit zyrtarisht i punësuar në fushën tuaj akademike, provimet dhe projektet përfundimtare, universiteti juaj dhe bota mbarë?**

A jeni gati të bëni një hap që do t'ju ndryshojë jetën për të zbuluar se ku do t'ju çojë rruga juaj profesionale? Shfrytëzoni këtë mundësi të artë dhe mësoni më shumë rreth karrierës tuaj të ardhshme përmes një praktike profesionale të paguar në Gjermani!

Gjatë 21 viteve të fundit, kemi mbështetur më shumë se 1 000 studentë dhe të diplomuar të rinj në këtë rrugëtim. Të gjithë ata kaluan tre deri në gjashtë muaj në një nga kompanitë më të njohura gjermane, ku patën mundësinë të zgjerorin njohuritë e fituara gjatë studimeve, t'i zbatonin ato në praktikë gjatë një praktike të paguar dhe të zbulonin se çfarë dëshirojnë me të vërtetë të bëjnë në jetë.

Gjenerata e ardhshme e përfituesve të bursës sonë do të fillojë praktikat e tyre më 1 korrik 2025.

A jeni gati të jeni pjesë e saj? Aplikoni për një bursë të Programit të Praktikës së Biznesit Gjerman për Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe krijoni historinë tuaj të suksesit në vendin tuaj. Siguroni themelin më të mirë për karrierën tuaj të ardhshme dhe zbuloni potencialin tuaj të vërtetë profesional!

Kush mund të aplikojë?

- Studentë të studimeve bachelor të regjistruar të paktën në semestrin e pestë në kohën e aplikimit
- Studentë të studimeve master
- Studentë të studimeve së doktoratures (PhD)
- Të diplomuar të rinj që kanë përfunduar studimet pas 1 janarit 2024
- Jo më të vjetër se 28 vjeç

- Kandidatë me një njohuri shumë të mirë të gjuhës angleze. Gjermanishtja nuk është parakusht, por gjithmonë një përparësi.

Në cilat fusha ofrojmë praktika?

- Administrim biznesi, ekonomi dhe drejtësi komerciale;
- Financë;
- Inxhinieri elektrike;
- Shkenca kompjuterike dhe informatike e biznesit;
- Inxhinieri mekanike;
- Inxhinieri industriale dhe logjistikë;
- Teknologji, shkenca natyrore dhe mjedisore;
- Inxhinieri ndërtimi dhe arkitekturë;
- Gazetari;
- Bujqësi.

Si të aplikoni?

Aplikimet janë të mundshme online përmes faqes sonë të internetit nga 1 tetori deri më 14 nëntor 2024:

www.stipendienprogramm.org

Mësoni më shumë rreth Programit të Praktikës së Biznesit Gjerman dhe procedurës së aplikimit këtu.

Cilat janë përfitimet e të qenit pjesë e Programit tonë të Praktikës së Biznesit Gjerman?

Përveç mbështetjes financiare, Programi ynë i Praktikës së Biznesit Gjerman ju udhëzon në të gjitha hapat organizativë dhe administrativë para dhe gjatë qëndrimit tuaj në Gjermani.

- Mbështetje financiare: pagesë nga kompanitë dhe një bursë mujore prej 400 EUR nga qeveria federale
- Përgatitje për intervistat me kompanitë
- Takime përgatitore në vendin tuaj
- Organizimi i vizave dhe lejes së punës nga Programi
- Mbështetje në gjetjen e akomodimit në Gjermani
- Mbulesë e logjistikeve për në Gjermani, në vendin e praktikës dhe kthimin në shtëpi
- Javë e orientimit në Berlin dhe rrethinat e tij (organizimi, akomodimi, rregullimet e udhëtimit)
- Takim gjatë mesit të peridhues së praktikës bashk me të gjithë gjeneratën në Gjermani (organizimi, akomodimi, rregullimet e udhëtimit)

Përfitimi më i vlefshëm i Programit tonë të Praktikës së Biznesit Gjerman është integrimi juaj në **klubin lokal të alumnit të Kosovës** si dhe aktivitetet në rrjetin rajonal të alumnit. Rrjeti rajonal i alumnit ju ofron mundësinë për të marrë pjesë në konferenca, punëtori dhe seminare në të gjithë rajonin, të dedikuara për zhvillimin tuaj profesional të mëtejshëm dhe mësimin gjatë gjithë jetës. Nga aktivitetet e ndërtimit të ekipeve (teambuilding) deri te rrjetëzimi profesional me punëdhënësit në Kosovoë – klubi rajonal i alumnit do të ju ndihmojë të zgjeroni njohuritë dhe të përmirësoni aftësitë që keni fituar gjatë praktikës, si dhe të kontribuoni në ndërtimin e urave në të gjithë rajonin, mirëkuptimin më të mirë ndërkulturor dhe rikthimin e trurit në rajon. Për të marrë një vështrim të aktivitetëve të rrjetit rajonal të alumnit, shikoni

[blogun në faqen tonë të internetit](#) ose në mediat tona sociale. Nëse mendoni se kjo është një mundësi që vjen një herë në jetë, klikoni “Apliko”.



“Eksperienca ime në Gjermani me Internship Programme of German Business ka qenë tejet transformative, duke më ndihmuar të zhvillohem si në aspektin personal ashtu edhe profesional. Përmes programit dhe praktikës më është zgjeruar perspektiva, më janë pasuruar njohuritë kulturore dhe kisha fatin të njihem me një gjeneratë me të cilën ndajmë të njejtat mendime dhe interesa. Jam shumë mirënjohëse për këtë mundësi dhe për ndikimin që ka për të pasur në jetën time deri në përfundim.”

Arta Partolla, MUNDA Textile Lichtsysteme GmbH, Gjenerata 2024



Apliko tani!



Prezantimet e Internship Programme of German Business



Instagram